



KOSOVA VOTON TË DIELËN, KQZ-ja THOTË SE JANË BËRË TË GJITHA PËRGATITJET



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka prezantuar të premten raportin mbi përgatitjet e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin Kosovës më 7 qershor. KQZ-ja ka bërë me dije se numri i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në zgjedhjet e 7 qershorit është 2,092,174 votues. Sipas raportit, në të 38 komunat e Kosovës tashmë janë shpërndarë materialet jo të ndjeshme zgjedhore, përfshirë kutitë dhe kabinetat e votimit, si dhe materialet e tjera përcjellëse. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se mbi 100 prokurorë janë angazhuar për ta mbrojtur votën e lirë të qytetarëve



DY MILIONË EURO PËR LINJAT AJRORE: SI DO TË SHPËRNDARHET NDIHMA E QEVERISË?

GAP-i: TË HYRAT E KOMUNAVE NGA TATIMI NË PRONË U RRIËN 19% NË 2025

F. 8



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



ZELENSKY I SHKRUAN LETËR TË HAPUR PUTINIT, I BËN THIRRJE PËR PAQE F. 2

IZOLIMI RAJONAL, 22% E QYTETARËVE TË BALLKANIT NUK UDHËTOJNË FARE TE FQINJËT F. 5

FSK-ja TESTON GATISHMËRINË LUFTARAKE NË GJAKOVË F. 3

EKONOMI



ODA EKONOMIKE AMERIKANE: GAZI NATYROR AMERIKAN DUHET TË BËHET PRIORITET STRATEGJIK PËR KOSOVËN F. 8

BIZNESET NË SHQIPËRI PRESIN NJË VERË TË MIRË, SHËRBI MET DHE TURIZMI RRIËN BESIMIN NË EKONOMI F. 8

SPORT



EMINI NË STAMBOLL: SPORTI ËSHËTË MJET I FUQISHËM PËR GJITHËPËRFSHIRJE DHE NDRYSHIM SHOQËROR F. 11

ZELENSKY I SHKRUAN LETËR TË HAPUR PUTINIT, I BËN THIRRJE PËR PAQE

KIEV, 5 QERSHOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i ka shkruar letër të hapur homologut të vet rus, Vladimir Putin, duke i bërë thirrje për të marrë pjesë në një takim mes dy udhëheqësve në një vend neutral, për të arritur marrëveshje për përfundimin e luftës.

Në letër thuhet se, meqë Uashingtoni është "plotësisht i përqendruar" në konfliktin me Iranin, "do të ishte gabim të pritej" që kjo gjendje të ndryshojë. Megjithatë, në letër thuhet gjithashtu se Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane duhet të përfshihen në procesin e paqes. "Ukraina është e gatshme për një armëpushim të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së bisedimeve. Kjo është praktikë standarde dhe zhvillimet e tanishme rreth Iranit vetëm sa e përforcojnë këtë argument", shkroi Zelensky, duke propozuar gjithashtu shkëmbimin e të gjithë robërve të luftës që mbahen nga të dyja palët.

Letra e Zelenskyt vjen pesë vjet pasi Rusia e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës, dhe tekta forcat ukrainase po i vazhdojnë luftimet kundër trupave ruse në një konflikt që ka arritur pothuajse në një ngjerc ushtarak. Derisa vijat e frontit të mbizotëruara nga lufta me dronë pothuajse nuk po

ndryshojnë fare, Rusia ka vazhduar t'i godasë qytetet ukrainase me raketa dhe sulme me dronë ndaj objektivave civile, në një përpjekje të dukshme për t'ia ulur moralin popullsisë.

Sulmi më i fundit, më 2 qershor, ishte aq madh sa tronditi edhe ukrainasit që kanë duruar vite bombardimesh. Gjashtë persona u vranë në Kiev, 16 në Dnipro dhe dhjetëra të tjerë u plagosën.

Në letrën e tij, Zelensky thekson se edhe Ukraina ka goditur Rusinë me "dronë dhe raketa", të cilat kryesisht kanë pasur në shënjestër industrinë energjetike që financon përpjekjet e luftës së Kremlinit. "Ju vazhdimisht shtyni, çdo disa muaj, afatet që vetë i keni vendosur për pushtimin e rajoneve tona - veçanërisht rajonit të Donjeckut. Dhe as këtë vit nuk do ta pushtoni", shkroi ai. "Por, në Ukrainë nuk duam luftë të përhershme. E dimë shumë mirë se jeta pa luftë është pafundësisht më e mirë. Dhe, ne duam ta arrijmë këtë", shtoi ai.

Ngecja e përpjekjeve për paqe

Thirrja e Zelenskyt për nisjen e një procesi të ri paqeje vjen pas përpjekjeve diplomatike të udhëhequra nga SHBA-ja pas



inaugurimit të Donald Trump në janar 2025. Këto përpjekje duket se kanë ngecur muajt e fundit, veçanërisht pas sulmeve amerikane dhe izraelite ndaj Iranit më 28 shkurt.

Lajmi për letrën u publikua derisa Putini po takohej me gazetarë të huaj në Shën Petersburg, ku po organizonte një forum ekonomik prestigjioz që shpesh quhet "Davosi i Rusisë". Hapja e kësaj ngjarjeje u la nën hije nga sulmet me dronë ukrainas që ngritën re tymi mbi qytet.

Putini u tha gazetarëve se Rusia dëshiron paqe, por se Trump nuk kishte arritur ta bindte palën

ukrainase. "Ne jemi sigurisht të gatshëm dhe të vendosur të arrijmë një marrëveshje me Ukrainën përmes mjeteve paqësore. Konkretisht mbi bazën e asaj që diskutuam në takimin me presidentin Trump", tha ai.

Putini po i referohej samitit të tij me Trumpin në Alaska në gusht 2025. Në atë kohë, Trump u kishte thënë gazetarëve se nuk ishte arritur asnjë marrëveshje. Ndërsa Putini po u përgjigjej pyetjeve, zëdhënësi i tij, Dmitriy Peskov, deklaroi se presidenti rus do të informohej më vonë për letrën e Zelenskyt.

Peskov citohet gjithashtu nga mediat shtetërore ruse të ketë

thënë se Zelensky mund të "vijë në çdo kohë në Moskë".

Ky ka qenë një reagim i zakonshëm i Kremlinit ndaj thirrjeve të mëparshme të Zelenskyt për bisedime. Në letrën e tij, presidenti ukrainas e përjashton në mënyrë të qartë mundësinë e një takimi qoftë në Moskë, qoftë në Kiev.

Më vonë, Trump u pyet për letrën e Zelenskyt gjatë një sesioni pyetjeje në Zyrën e Ovalit. "Jam i lumtur që ndoshta po flasim për t'u takuar. Mendoj se kemi pasur shumë ndikim në këtë", tha Trump. "Do të ishte shumë mirë nëse do të takoheshin. Duhet ta bëjnë; ta zgjidhin këtë çështje".

FRANCA DHE GJERMANIA PROPOZOJNË INTEGRIM GRADUAL TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE

PARIS, 5 QERSHOR - Në prag të samitit BE-Ballkani Perëndimor, Gjermania dhe Franca e kanë paraqitur një të ashtuquajtur non-paper, përmes të cilit propozojnë integrimin gradual të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë në programet dhe politikën e Bashkimit Evropian.

Qëllimi i kësaj nisme është përshtetimi i integrimit të vendeve kandidatë dhe dhënia e një shtyese të re për reforma.

Non-paper është dokument joformal që përdoret në qarqet diplomatike evropiane për paraqitjen e ideve të reja, testimin e qëndrimeve ose propozimin e zgjidhjeve, pa e detyruar palën që e paraqet atë të marrë qëndrim formal.

Dokumenti franko-gjerman, i përgatitur nga kabinetet e kancelarit gjerman, Friedrich Merz, dhe presidentit francez, Emmanuel Macron, nisën nga vlerësimi se politika e zgjerimit ka nevojë për një impuls të ri politik.

Vetë Macron dhe Merz konfirmuan se në samitin BE-



Ballkani Perëndimor, që zhvillohet në Tivat të Malit të Zi, do të diskutohet propozimi i përbashkët franko-gjerman. "Tani do të zhvillojmë bisedime me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për këtë çështje. Kjo është qartazi një nga lidhjet tona kryesore, së bashku me perspektivën e zgjerimit, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme edhe nga këndvështrimi gjeopolitik", tha Macron gjatë mbërritjes në ambientet ku do t'i zhvillojë punimet samiti. "Në këtë rajon

bëhet fjalë për pavarësinë evropiane në fusha si energjia, siguria dhe menaxhimi i rrugëve migratore. Prandaj është shumë e rëndësishme që të jemi në gjendje të ecim përpara", shtoi ai. Propozimi i përbashkët përbën nismën e dytë të kancelarit gjerman Merz lidhur me politikën e zgjerimit, pasi në maj ai doli me propozimin për "zgjidhje kreative" për vendet e përfshira në procesin e anëtarësimit në BE. Njëkohësisht, kjo është nisma e parë e përbashkët e Francës dhe

Gjermanisë, dy prej shteteve më me ndikim në BE, kushtuar së ardhmes së procesit të zgjerimit. Në Tivat, kancelari gjerman, Merz, vlerësoi se procesi i zgjerimit të BE-së po ecën shumë ngadalë dhe se nevojiten ide të reja për t'i nxitur më tej vendet e rajonit në zbatimin e reformave.

Ai paralajmëroi se edhe vetë BE-ja duhet të dëshmojë se është e aftë për zgjerim të mëtejshëm. "Natyrisht, ka një sërë çështjesh të cilave duhet t'u japim përgjigje dhe për të cilat duhet të veprojmë së bashku. Por, gjithçka tregon se kjo pjesë e Evropës ka një perspektivë evropiane dhe i përket Bashkimit Evropian. Fakti që prej 13 vitesh nuk kemi pranuar asnjë anëtarë të re tregon se mangësi ka pasur edhe në anën e Bashkimit Evropian. Pikërisht këtë duam ta tejkalojmë sot", deklaroi kancelari gjerman para fillimit të samitit.

Merz bëri të ditur se para samitit kishte zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të vendeve të rajonit. Ai shprehu shpresën se

pjesëmarrësit do të arrijnë një pajtim të përbashkët, në mënyrë që idetë e reja të mund të nisnin më pas të zbatohen në Bruksel. "Jam i inkurajuar nga bisedimet që zhvilluam këtë mëngjes. Megjithatë, përpara nesh mbetet ende një rrugë e gjatë. Por ky proces është i realizueshëm. Disa vende, e veçanërisht vendi mikpritës, Mali i Zi, tashmë kanë arritur në një nivel ku mund të sigurojmë rezultate të përbashkëta shumë shpejt. Shpresoj që kjo të ndodhë", u shpreh Merz.

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Mali i Zi po e kërkojnë anëtarësimin në BE prej shumë vitesh, por ende nuk arritur t'i përmbushin kushtet e nevojshme, sipas bllokut.

Çdo shtet ndodhet në fazë të ndryshme të procesit të anëtarësimit, por Mali i Zi dhe Shqipëria janë shumë më përpara në këtë rrugëtim. Ndërsa Kosova është akoma vendi i vetëm i rajonit që nuk e ka as statusin e vendit kandidat.

PROJEKTI PREJ MILIARDA EUROSH QË PO NXIT POLEMIKA NË SHQIPËRI

Një zonë e mbrojtur pranë Vlorës. Një projekt turistik me vlerë prej miliarda eurosh. Protesta të banorëve. Dhe, një hetim nga prokuroria speciale. Çfarë po ndodh në Shqipëri?

VLORE, 5 QERSHOR - Në Zvërnec, fshat pranë qytetit bregdetar të Vlorës, në Shqipëri, punimet përgatitore për një projekt turistik, të lidhur me planet e shpallura më herët nga Jared Kushner, dhëndër i presidentit amerikan Donald Trump, për ndërtimin e hoteleve dhe vilave, nxitën protesta dhe një varg shqetësimesh.

Banorë, aktivistë mjedisorë dhe përfaqësues të shoqërisë civile përmendën tri kryesore: ndikimin në mjedis, paqartësitë mbi pronësinë e tokës ku planifikohet ndërtimi, dhe mungesën e transparencës për projektin.

Më 30 maj, protesta në Zvërnec u shoqërua me përplasje të dhunshme me punonjës të sigurimit privat. Protestat më pas u bartën edhe në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, ku u kërkuar anulimin e projektit dhe dorëheqja e kryeministrit Edi Rama.



Çfarë tha Rama?

Kreu i ekzekutivit shqiptar po e mbron projektin. Ai tha se investimi në Zvërnec mund të arrijë vlerën prej 4 miliardë eurosh, dhe se mund ta vendosë Shqipërinë në "listën e kampionëve" të turizmit.

Sipas Ramës, projekti do të zhvillohet vetëm në pronë private, laguna nuk do të preket dhe investitorët kanë premtuar se gjithçka do të bëhet sipas ligjit. "Nuk ka asnjë shans që investimi të ndalojë për aq kohë sa unë do të jem këtu", u shpreh ai.

Por, kryeministri i Shqipërisë tha se për Zvërnecin ende nuk ka një projekt konkret, por vetëm një koncept të miratuar me kushte, ndërsa studimi mjedisor ende nuk është përfunduar.

Përfshirja e prokurorisë speciale

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar - SPAK konfirmoi më 1 qershor se ka nisur një hetim lidhur me Zvërnecin. Rama tha më pas se SPAK-u kishte bllokuar një transaksion

prone, të lidhur me projektin. Më 3 qershor, ai tha se SPAK-u ka verifikuar pronësinë e investitorëve të huaj mbi tokën ku është planifikuar projekti turistik. Sipas tij, është sqaruar origjina e fondeve të kaluara përmes bankës, ndërsa fondet janë mbajtur të ngrira dhe nuk i janë kaluar shitësit, për të cilin ka një proces hetimor.

SPAK-u, ndërkaq, i tha Radios Evropa e Lirë (REL) se çështja ndodhet në një fazë procedurale, dhe se hollësitë nuk mund të bëhen publike tani për tani.

Kush janë blerësit e tokës?

Pronare e zonës së rrethuar në Zvërnec rezultojnë të jetë kompania Albania Land Development.

Të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit tregojnë se pronarë të kësaj kompanie janë vëllezërit nga Katari, Mohamadmoataz Mhd Ruslan Alkhayat dhe Ramez Mhd Ruslan Alkhayat.

Më 29 prill, Këshilli Kombëtar i Territorit dha leje për rrethimin dhe për punime përgatitore për rrugët e qasjes brenda pronës.

Leja iu dha shoqërisë Zvërnec South Adriatic Development, në cilësinë e zhvilluesit të punimeve përgatitore.

Banorë të Zvërnecit i kanë thënë REL-it se janë të përfshirë në një kontest gjyqësor për pronësinë e tokës, që ata pretendojnë se u është marrë padrejtësisht.

Pse përmendet Kushner?

Në mars të vitit 2024, Kushner tha se synon të ndërtojë hotele dhe qindra vila në Zvërnec. Sipas gazetës New York Times, ai do të përfshihej përmes firmës së tij investuese, Affinity Partners, e mbështetur nga fonde saudite dhe investitorë të tjerë të huaj.

REL-i iu drejtua Affinity Partners lidhur me investimet e parapara në Shqipëri dhe protestat që po zhvillohen. Përgjigjja erdhi nga Sazan Real Estate Development LLC, e cila tha se i respekton "proceset e vazhdueshme publike dhe institucionale" dhe është e gatshme të ecë përpara ndërsa ato zhvillohen.

Kompania figuron në regjistrin e pronarëve përfitues si një nga personat juridikë indirektë në

strukturën e pronësisë së kompanisë Albania Land Development.

Kërkesa për transparencë

Përfaqësues të shoqërisë civile dhe analistë në Shqipëri konsiderojnë se pikërisht mungesa e transparencës është në qendër të debatit për Zvërnecin.

Rigels Xhemollari, nga organizata Qëndresa Qytetare, tha për REL-in se çështja mund të zgjidhet vetëm nëse bëhen publike dokumentet kryesore. Sipas tij, nëse nuk ka transparencë, projekti do të mbetet i kontestuar.

Politologu Ermal Hasimja beson se zgjidhja duhet kërkuar te zbatimi i ligjit, por mendon se problemi është bërë më i madh për shkak të ndryshimeve ligjore që, sipas tij, kanë hapur rrugë për abuzime në zona të tilla. "Nëse do të ketë transparencë të plotë mbi ata që kanë pronat, si i kanë marrë, mbi ata që do të investojnë, duke parë edhe aspektin e lejeve mjedisorë dhe duke respektuar në të gjitha rastet ligjin, besoj se do të gjendet rruga e duhur", tha Hasimja për

REL-in.

Për gazetarin dhe analistin Ben Andoni, "projekte të tilla nuk mund të kalojnë thjesht nëpërmjet protagonizmit të kryeministrit Rama dhe të disa individëve".

Ai tha për REL-in se çështja e Zvërnecit ka nxjerrë në pah një problem më të madh: atë të pronësisë, "që është gati një 'kancer' për zhvillimin e Shqipërisë".

Efektet e protestave

Xhemollari kujton se protesta ka sjellë më shumë vëmendje mediatike, ndërkombëtarizim dhe ndërgjegjësim qytetar për Zvërnecin.

Hasimja i sheh protestat si shenjë pozitive të aktivizimit qytetar, sidomos të rinjve, ndërsa Andoni e cilëson pjesëmarrjen e gjeneratës Z risinë më të madhe.

Po pretendimet për ndikime të huaja? Xhemollari i hedh poshtë ato, duke thënë se "pas tyre nuk ka as grekë, as serbë, as izraelitë, as agentë".

Edhe Andoni konsideron se pretendimet e tilla janë të zmadhuara dhe se protesta është më shumë rezultat i pakënaqësive të grumbulluara.

FSK-ja teston gatishmërinë luftarake në Gjakovë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Në kuadër të ngritjes dhe avancimit të kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Komanda e Forcave Tokësore dhe njësi të kombinuara si togu i IVR-së, Kompania Mbështetëse e

RML-së, togje të Komandës së Logjistikës dhe Policisë Ushtarake, realizuan ushtrimin fushor validues "Ujku i Pamposhtur 01" në zonat e Aeroportit të Gjakovës dhe Babaj të Bokës. Qëllimi i ushtrimit ishte

validimi i aftësive operacionale, rritja e gatishmërisë luftarake, koordinimi ndërmjet njësive dhe zhvillimi i kapaciteteve për përmbushjen e detyrave në përputhje me standardet më të larta profesionale.





KOSOVA VOTON TË DIELËN, KQZ-ja THOTË SE JANË BËRË TË GJITHA PËRGATITJET

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka prezantuar të premtën raportin mbi përgatitjet e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin Kosovës më 7 qershor. KQZ-ja ka bërë me dije se numri i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në zgjedhjet e 7 qershorit është 2,092,174 votues. Sipas raportit, në të 38 komunat e Kosovës tashmë janë shpërndarë materialet jo të ndjeshme zgjedhore, përfshirë kutitë dhe kabinet e votimit, si dhe materialet e tjera përcjellëse. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se mbi 100 prokurorë janë angazhuar për ta mbrojtur votën e lirë të qytetarëve

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka prezantuar të premtën raportin mbi përgatitjet e deritanishme për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Raporti pasqyron përgatitjet logjistike dhe administrative për ditën e zgjedhjeve.

KQZ-ja ka bërë me dije se numri i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në zgjedhjet e 7 qershorit është 2,092,174 votues.

Kjo listë sipas KQZ-së, përmban 15,884 votues më shumë se në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend, të cilat u mbajtën më 28 dhjetor 2025. "Sipas të dhënave nga

Lista Votuese, numri i qytetarëve me të drejtë vote në vendvotime, në Republikën e Kosovës është 1,959,962 votues, ndërkaq numri i qytetarëve që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës është 132,212 votues, prej të cilëve, 100,970 janë regjistruar për të dërguar fletëvotimin në kutinë postare jashtë Kosovës, 3,518 për të dërguar fletëvotimin në kutinë postare në Kosovë dhe 27,724 për të votuar fizikisht në përfaqësi diplomatike", ka njoftuar KQZ-ja.

Numri i votuesve të rinj që do të votojnë për herë të parë në zgjedhjet e parakohshme më 7 qershor, është: 22,685 votues, prej të cilëve: 16,934 votues konsiderohen të rinj që, pas zgjedhjeve për Kuvend (28.12.2025), kanë arritur

moshën 18 vjeç dhe do të votojnë për herë të parë në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor. Prej tyre 8,752 (51.68 %) janë meshkuj, ndërsa 8,182 (48.31 %) janë femra; dhe 5,751 votues konsiderohen të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh, ose votues që kanë rikthyer shtetësinë e Kosovës.

Sipas raportit, në të 38 komunat e Kosovës tashmë janë shpërndarë materialet jo të ndjeshme zgjedhore, përfshirë kutitë dhe kabinet e votimit, si dhe materialet e tjera përcjellëse.

Po ashtu, janë transportuar pajisjet e teknologjisë informative, duke përfshirë kamerat për vendvotime,

kompjuterët, monitorët dhe pajisje të tjera mbështetëse. Gjithashtu, janë pranuar dhe kontrolluar të gjitha format dhe formularët zgjedhorë, ndërsa shpërndarja e tyre në komuna pritet të përfundojë gjatë ditës së sotme. Ndërkaq, materialet e ndjeshme zgjedhore, si fletëvotimet, listat përfundimtare të votuesve, vulat dhe materialet e tjera përkatëse, do të shpërndahen në komunat e Kosovës më 6 qershor, nën përcjelljen e Policisë së Kosovës.

Raporti vë në pah edhe përfundimin e trajnimeve për këshillat e vendvotimeve dhe për stafin që do të angazhohet në publikimin e rezultateve preliminare. Deri më tani janë funksionalizuar 30 Qendra Komunale të Numërimit, ndërsa tetë të tjera pritet të përfundojnë gjatë ditës së sotme. Po ashtu, ka vazhduar edhe trajnimi i ekipeve të numërimit.

Sa i përket votimit jashtë Kosovës, materialet zgjedhore për votimin fizik në përfaqësitë diplomatike janë dërguar materialet zgjedhore, ndërsa janë zhvilluar edhe trajnimet për stafin që do të angazhohet në këto qendra votimi.

Në raport u bë e ditur se deri më 4 qershor janë tërhequr gjithsej 39,405 zarfe me

fletëvotime nga kutitë postare të KQZ-së në Gjermani dhe Zvicër. Gjithashtu, për zgjedhjet e 7 qershorit janë regjistruar 3,144 votues me nevoja të veçanta.

Në përfundim, u vlerësua se përgatitjet për procesin zgjedhor janë zhvilluar sipas planifikimeve dhe se shpërndarja e materialeve zgjedhore është realizuar me kohë, duke krijuar kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

**Prokurori i Shtetit:
Mbi 100 prokurorë të
angazhuar për ta
mbrojtur votën e lirë të
qytetarëve**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka bërë të ditur se për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen të dielën më 7 qershor 2026, Prokurori i Shtetit ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të realizuar mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve, duke garantuar integritetin e procesit zgjedhor.

Në njoftim bëhet e ditur se në këto zgjedhje janë angazhuar së bashku mbi 100 prokurorë të shtetit dhe zyrtarë të sistemit

IZOLIMI RAJONAL, 22% E QYTETARËVE TË BALLKANIT NUK UDHËTOJNË FARE TE FQINJËT

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Pavarësisht përpjekjeve shumëvjeçare për bashkëpunim rajonal dhe nismave për lëvizjen e lirë, qytetarët e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të mbeten gjeografikisht të izoluar nga njëri-tjetri.

Të dhënat "Barometrit të Ballkanit 2025" nga Këshilli i Bashkimit Rajonal tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e banorëve të rajonit 22% nuk kanë vizituar kurrë asnjë nga ekonomitë fqinje për shkak të barrierave politike, mungesës së infrastrukturës etj., shkruan Monitor.al.

Rezultatet e Anketës tregojnë se Bosnja dhe Hercegovina është vendi më pak i vizituar nga vendet e tjera të rajonit, ku mesatarisht 46% e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë shkelur kurrë atje.

Ajo ndiqet nga Maqedonia e Veriut 38%, Shqipëria dhe Kosova me nga 37% secila.

Në kahun tjetër, Mali i Zi rezulton vendi më i eksploruar, me vetëm 21% të qytetarëve të rajonit që nuk e kanë vizituar asnjëherë.

Shqiptarët dhe Kosova:

Një urë e fortë, por Bosnja dhe Serbia mbeten "tokë e panjohur"

Për qytetarët e Shqipërisë, Kosova mbetet destinacioni më i afërt dhe më i vizituar. Vetëm 20% e shqiptarëve të Shqipërisë thonë se nuk kanë qenë kurrë në Kosovë. Ky raport është edhe më i fortë në kahun e kundërt, ku vetëm 4% e qytetarëve të



Kosovës nuk e kanë vizituar kurrë Shqipërinë, duke konfirmuar lidhjet e ngushta kulturore, etnike dhe turistike.

Megjithatë, lëvizshmëria e shqiptarëve zbehet ndjeshëm kur bëhet fjalë për pjesën tjetër të rajonit: 72% e shqiptarëve të Shqipërisë nuk kanë vizituar kurrë Serbinë. 66% e tyre nuk kanë qenë kurrë në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Për Kosovën, izolimi me këto dy vende është edhe më ekstrem, kryesisht për shkak të barrierave politike dhe regjimit të vizave me Bosnjën. 79% e qytetarëve të

Kosovës nuk kanë vizituar kurrë Bosnjën dhe 67% nuk kanë qenë kurrë në Serbi.

Fqinjësi pa komunikim

Të dhënat nxjerrin në dritë edhe hendeqe të tjera të thella ndërmjet vendeve që ndajnë kufij të përbashkët. Për shembull, 68% e qytetarëve të Serbisë nuk kanë vizituar kurrë Shqipërinë, ndërsa 60% e qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës nuk kanë shkelur kurrë në Shqipëri apo Kosovë. Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi

shfaqen si vendet më neutrale dhe më të aksesueshme për të gjithë. Mali i Zi është veçanërisht i vizituar nga serbët (vetëm 7% nuk e kanë vizituar dhe nga boshnjakët, vetëm 8% nuk e kanë vizituar, kryesisht për shkak të turizmit bregdetar dhe lidhjeve historike.

Një e pesta e rajonit nuk lëviz fare

Një tjetër tregues negative për integrimin rajonal është se 22% e qytetarëve në nivel rajoni

deklarojnë se nuk kanë vizituar asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo shifër shkon deri në 36% për qytetarët e Malit të Zi dhe 30% për ata të Maqedonisë së Veriut, duke dëshmuar se për një pjesë të madhe të popullsisë.

Anketa e Barometrit 2025 tregon se pa heqjen definitive të barrierave politike dhe pa përmirësimin e infrastrukturës rrugore e hekurudhore, integrimi i Ballkanit do të mbetet më shumë një projekt në letër sesa një realitet i jetuar nga qytetarët e tij.

prokurorial, të cilët do të qëndrojnë kujdestarë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, deri në përfundim të procesit zgjedhor, me qëllim të procedimit të çdo parregullsie që mund të ndodhë në këto zgjedhje.

Prokurori i Shtetit i fton qytetarët e Republikës së Kosovës, të gjitha subjektet politike, institucionet apo organizatat e ndryshme, që të denoncojnë tek prokuroritë përkatëse, çdo rast, për të cilin kanë dyshime se po keqpërdoret ose manipulohet vota në çfarëdo mënyre dhe nga kushdo qoftë.

Ndërkaq Misioni Vendor për Vëzhgimin e Zgjedhjeve "Demokracia në Veprim", zhvilluam një takim me kryesuesin e KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, gjatë të cilit diskutuam çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit zgjedhor, integritetin e procesit të votimit, akreditimin e organizatave vëzhguese, si dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të procesit zgjedhor.

Gjatë takimit, ritheksuam rëndësinë e transparencës, llogaridhënies dhe respektimit të standardeve demokratike si elemente kyçe për forcimin e

besimit të qytetarëve në proceset zgjedhore dhe institucionet përgjegjëse për administrimin e tyre.

DnV-ja: Ditët e fushatës ishin me dominim të liderëve, pa përballje midis kandidatëve dhe ofertave politike

Violeta Haxholli nga Demokracia në Veprim ka thënë se në këto zgjedhje po garojnë gjithsej 21 subjekte politike me 902 kandidatë, prej të cilëve vetëm 34 % janë gra. Ajo ka theksuar se për dallim nga zgjedhjet e dhjetorit 2025, subjektet politike kanë rifreskuar listat e tyre të kandidatëve, në disa raste edhe deri 50 %, por pjesëmarrja e grave në lista ka mbetur relativisht e njëjtë. "Numri më i madh i kandidatëve vjen nga komunat me peshë më të madhe elektorale. Kështu, Prizreni prin me numrin më të madh të kandidatëve në nivel vendi me gjithsej 157 kandidatë, pasuar nga Prishtina me 153, Ferizaj me 77, Peja 68 dhe Fushë-Kosova me 55 kandidatë. Oferta programore e subjekteve

politike në këto zgjedhje mund të vlerësohet si riciklim i ofertës së kaluar, por i ambalazhuar në formë të zotimeve, kryesisht të orientuara në fushën e energjisë, pagave, skemave sociale, zhvillimit të infrastrukturës dhe teknologjisë. Shumica e subjekteve politike shqiptare kanë publikuar tanimë këto programe në uebfaqet e tyre zyrtare", ka thënë ajo.

Haxholli ka theksuar se një shqetësim i vazhdueshëm mbetet konkurrenca e pabarabartë në garën zgjedhore. "Përdorimi i resurseve publike para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, përfshirë vendimet e qeverisë në detyrë për shpërndarje të përfitimeve financiare për qytetarët, kanë krijuar avantazh të padrejtë elektorale për partinë në pushtet. Sa i përket ecures së fushatës, në pesë ditët e para është vërejtur intensitet më i lartë i aktiviteteve zgjedhore në terren, ku subjektet politike janë përqendruar në tubimet hapëse të fushatës në qendrat kryesore të Kosovës. Janë evidentuar edhe raste të përdorimit të fëmijëve në disa tubime të subjekteve politike, për të cilat tashmë janë

deponuar dy ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP). Për dallim nga rrjedha e qetë e aktiviteteve zgjedhore në terren, fushata në hapësirën online, përkatësisht në rrjetet sociale është dukshëm më e ashpër, për shkak të gjuhës së urrejtjes që shpërfaqet nga përkrahësit e partive. Në anën tjetër, përdorimi i gjuhës fyese dhe diskriminuese nga subjektet politike, ndonëse në nivel më të ulët krahasuar me proceset e mëparshme zgjedhore, tregon se hapësira online vazhdon të paraqesë sfida serioze për cilësinë e debatit publik", është shprehur ajo.

Zyrtarët e DnV-së kanë theksuar se gjatë periudhës së fushatës janë identifikuar 56 raste që përfshijnë gjuhë urrejtjeje, gjuhë shpifëse ose përçmuese, dezinformim dhe përbajtje jashtë kontekstit.

Ndërkaq monitorimi i 152 portaleve informative në gjuhën shqipe dhe serbe ka evidentuar mbi 7 mijë komente që përbajnë gjuhë të urrejtjes, që përfaqësojnë rreth 6 % të totalit të komenteve të analizuara gjatë periudhës së monitorimit. "Të dhënat tregojnë një nivel shqetësues të sulmeve verbale

në hapësirën online, veçanërisht ndaj grave pjesëmarrëse në procesin zgjedhor, duke ndikuar negativisht në cilësinë e debatit publik dhe në pjesëmarrjen e tyre në diskutimin politik", ka thënë Haxholli.

Ajo ka shtuar se fushata po karakterizohet nga një shkallë e theksuar personalizimi dhe centralizimi, ku liderët politikë dhe kandidatët për pozitë kryesore dominojnë aktivitetet publike dhe komunikimin politik, ndërsa kandidatët për deputetë kanë rol më të kufizuar në paraqitjet publike dhe mediale. "Si rezultat, kandidatët po shfrytëzojnë më shumë rrjetet sociale për promovimin e tyre, përmes publikimit të qëndrimeve, fotografive dhe videove nga takimet me qytetarët. Po ashtu, është evidentuar rritje e përdorimit të videove kreative me efekte vizuale, duke reflektuar angazhimin e kompanive të specializuara të dizajnit dhe prodhimit të përbajtjes, gjë që tregon për rritje të shpenzimeve në fushatën digjitale. Numri i postimeve që bëhen nga kandidatët e partive arrin deri në 300 në ditë", ka deklaruar Haxholli.

Kurti: Kosova ka potencial për t'u bërë pjesë e historive globale të suksesit në teknologji dhe inovacion

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar kompaninë "Fresha" së bashku me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, dhe kandidatin për deputet Ibir Kërçeli, duke e vlerësuar atë si shembull të inovacionit dhe ekonomisë digjitale. "Aktualisht kjo kompani

bashkëpunon me mbi 140 mijë biznese nga vende të ndryshme të botës dhe me 450 mijë profesionistë. Kështu, me më shumë se 1 miliard termine të realizuara po e transformon industrinë e bukurisë dhe estetikës në mbarë botën. Kosova ka talent, ka të rinj të aftë dhe ka potencial për t'u bërë pjesë e

historive të tilla të suksesit dhe sa më shumë investim në dije, teknologji dhe inovacion, aq më shumë zhvillim dhe mundësi për vendin tonë. Si qeveri kemi investuar dhe do të investojmë shumë në inovacion, teknologji dhe në zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit", ka thënë Kurti.



HAMZA: BIZNESET QË INVESTOJNË DHE HAPIN VENDE PUNE DO TA KENË MBËSHTETJEN E PLOTË TË SHTETIT



PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës dhe kandidati për Kryeministër, Bedri Hamza, ka vizituar kompaninë "Muqa Solar", të cilën e cilësoi si një shembull të investimeve të mençura që krijojnë vlerë për ekonominë dhe mirëqenie për qytetarët.

Hamza theksoi se zhvillimi ekonomik i Kosovës duhet të mbështetet tek bizneset prodhuese, inovative dhe investimet në energjinë e pastër, të cilat krijojnë vende të reja pune dhe rrisin konkurrueshmërinë e vendit. "Muqa Solar është dëshmi se investimet e mençura

krijojnë vlerë për ekonominë dhe mirëqenie për qytetarët. Bizneset që investojnë, hapin vende pune dhe sjellin inovacion do ta kenë gjithmonë mbështetjen e shtetit në qeverisjen time", deklaroi Hamza.

Ai kritikoi qeverinë aktuale për mungesën e rezultateve konkrete në zhvillimin ekonomik dhe realizimin e projekteve kapitale, duke theksuar se pas gati gjashtë vitesh qeverisje dhe shpenzime rekord, qytetarët ende presin investimet e premtuara. "Ku janë autostradat, fabrikat, çerdhjet, stadiumet, parqet solare, digat dhe shumë projekte të tjera që iu

premtuan qytetarëve?", pyeti Hamza.

Sipas tij, Kosova ka nevojë për një qeveri që e shoh sektorin privat si partner zhvillimi dhe që krijon kushte më të mira për investime, me tatime më të ulëta, më shumë mbështetje për bizneset dhe politika që nxisin prodhimin vendor.

Hamza vlerësoi se qytetarët tashmë e kanë kuptuar dështimin e qeverisë aktuale dhe se zgjedhjet e 7 qershorit janë mundësi për një drejtim të ri zhvillimor për vendin. "Stop krizës. Ndrysho Kosovën", përfundoi Hamza.

HAXHIU NË TIVAT TAKON KRYEMINISTRIN E ÇEKISË, KËRKON MBËSHTETJEN E SHTETIT ÇEK PËR PROCESET INTEGRUESE

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, në margjinat e Samitit BE, Ballkani Perëndimor në Tivat, u takua me kryeministrin e Çekisë, Andrej Babis. Në njoftimin e Presidencës bëhet e ditur se gjatë takimit Haxhiu e falënderoi Çekinë për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës në shtetndërtim, në proceset euroatlantike dhe në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Ajo vlerësoi marrëdhëniet e mira ndërmjet Kosovës dhe Çekisë, duke theksuar se avancimi i përfaqësimit

diplomatik me ambasadorë të plotë pasqyron nivelin e bashkëpunimit dhe besimin e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve.

Në takim u diskutua për rrugën evropiane të Kosovës dhe për rëndësinë e një procesi të besueshëm të zgjerimit.

U.d. presidentja Haxhiu shprehu mirënjohje për mbështetjen e Çekisë ndaj perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe kërkoi mbështetjen e saj edhe për hapat e ardhshëm të Kosovës, përfshirë dërgimin e Pyetësorit të Komisionit Evropian dhe ecjen drejt statusit të vendit kandidat.

Haxhiu theksoi se Kosova e



shoh Çekinë si partnere të rëndësishme edhe në fushën ekonomike, me mundësi të reja bashkëpunimi në energji, teknologji të gjelbra, inovacion, digjitalizim, shëndetësi, infrastrukturë dhe industri të avancuar.

Ajo po ashtu shprehu mirënjohjen e Kosovës për kontributin e Çekisë në KFOR dhe për angazhimin e saj të vazhdueshëm në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë dhe në rajon.

U.d. presidentja Haxhiu riafirmoi përkushtimin e Kosovës për thellimin e marrëdhënieve me Çekinë dhe zgjerimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.

Policia arreston aktivistin e Listës Serbe nën dyshimin për ryshfet në lidhje me votimin

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Policia e Kosovës ka njoftuar të premtën se e ka arrestuar një burrë nga komuna e Graçanicës pranë kryeqytetit Prishtinë, nën dyshimin për marrje dhe dhënie të ryshfetit në lidhje me votimin, dy ditë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

të 7 qershorit.

Policia tha se gjatë kontrollit ka gjetur dhe konfiskuar materiale dëshmuese, si dhe ka marrë në pyetje dy dëshmitarë.

Derisa Policia nuk tregoi se kush është i arrestuar, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë njoftoi se i ndaluar

është aktivisti i Listës Serbe, Aleksandar Trajković nga fshati Uglari.

Ajo e dënoi arrestimin e tij si "trysni shtesë ndaj popullit serb me qëllim që Albin Kurti (kryeministri në detyrë i Kosovës) ta ndihmojë të preferuarin e tij Nenad Rashiq në garën zgjedhore".

Nga subjektet politike serbe në zgjedhjet e së dielës marrin pjesë vetëm Lista Serbe, partia kryesore e serbëve që vepron me mbështetjen e Beogradit - dhe partia Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit, i cili deri tani ka qenë pjesë e Qeverisë së Kurtit.



DY MILIONË EURO PËR LINJAT AJRORE: SI DO TË SHPËRNDARHET NDIHMA E QEVERISË?

Rreth dy javë para zgjedhjeve parlamentare, Qeveria në detyrë e Kosovës ndau 2 milionë euro për subvencionimin e linjave ajrore që operojnë në destinacione të lidhura me diasporën. Vendimi u kritikua si tentim për ndikim në zgjedhje, ndërkaq mbetet e paqartë se si vendimi mund të ndikojë në çmimin e biletave apo rritjen e turizmit



PRISHTINË, 5 QERSHOR - Në kuadër të një mase të quajtur "Mbështetja e Mërgatës", Qeveria në detyrë e Kosovës vendosi më 26 maj për mbështetjen e kompanive ajrore për linjat që lidhin vendin me destinacionet nga ku më së shumti vjen diaspora e vendit. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, tha se vendimi u mor "përballë rrezikut që një pjesë e fluturimeve të planifikuara gjatë muajve korrik dhe gusht të anulohen për shkak të rritjes së kostos së karburantit".

"Anulimi i fluturimeve në muajt e verës do të nënkuptonte që një numër i konsiderueshëm i bashkatdhetarëve të mos mund të vinin, siç vijnë zakonisht në muajt korrik dhe gusht. E kjo do të ishte keq për ta dhe familjet e tyre, por do të ishte fatale edhe për ekonominë e vendit", u shpreh Kurti në një postim në "Facebook", më 27 maj. Partitë opozitare, por edhe shoqëria civile, e kritikuan vendimin që u mor para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit, si tentim për ndikim të votuesit nga diaspora, të cilët në zgjedhjet e kaluara e votuan në shumicë Lëvizjen Vetëvendosje.

Nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) e cilësuan masën si ndërhyrje me motive elektorale. "Një qasje e tillë po e shndërron garën zgjedhore në një proces krejtësisht të pabarabart, ku partia në pushtet krijon epërsi përmes parasë publike dhe avantazhit institucional, e jo përmes një gare të drejtë politike", shkroi hulumtuesi i KDI-së, Eugen Cakolli, në Facebook, më 26 maj. Kurti, në anën tjetër, iu përgjigj këtyre kritikave, duke thënë se masa nuk ka të bëjë me zgjedhjet, pasi që, sipas tij, ajo do

të ndikojë periudhën e paszgjedhjeve, gjegjësisht të gjithë muajt e verës. "Pra, nuk bëhet fjalë për blerje biletash apo ardhje të organizuar për zgjedhje, siç u pretendua nga disa qarqe të bllokut opozitar. Kjo është një skemë mbështetëse, sikurse e bëjnë shumica e shteteve të rajonit", shkroi Kurti në "Facebook".

Si do të funksionojë skema?

Hollësitë e plota të ndarjes së fondeve ende nuk janë bërë publike në formë të dokumentit, por sipas deklaratave publike të Qeverisë në detyrë, kompanitë ajrore do të mund të aplikojnë për këto fonde nëse i ruajnë ose i rrisin operimet e tyre nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari". Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, në një intervistë për televizionin Kanal 10, tha se kompanitë ajrore do të përfitojnë nga 3 euro për pasagjer në sezonin veror të fluturimeve. Për të përfituar këto fonde, kompanitë duhet të përmbushin disa kriteret. Sipas Muratit, masa vlen për linjat ajrore, nëse "e mirëmbajnë frekuencën e fluturimeve për mbi 85 për qind të planit për vitin 2026".

Gjithashtu, sipas Muratit, secili fluturim duhet të ketë mbi 80 për qind të karrigeve të mbushura. Pjesa prej 3 eurosh, sipas tij, do të bëhet në bashkëpunim me Aeroportin e Prishtinës. Kësisoj, Qeveria do të paguajë 2.10 euro, ndërsa pjesën tjetër Aeroporti, tha Murati.

Ai pohoi se kompanitë ajrore shpesh reduktojnë numrin e fluturimeve kur përballen me rritje të kostove, duke bashkuar udhëtarët në më pak linja, dhe se

masa synon ta parandalojë këtë. Murati argumentoi se kjo do të ndikonte në numrin e pasagjerëve në Aeroportin e Prishtinës dhe, rrjedhimisht, në të hyrat që gjenerohen për shtetin e Kosovës.

Megjithatë, nuk u bë e ditur se për cilat linja në veçanti do të ndahet subvencion, dhe sa nga fondi prej 2 milionë eurosh mund të përfundojë te operatorë të veçantë. Gjermania dhe Zvicra konsiderohen ndër destinacionet kryesore prej nga vjen diaspora kosovare. Sipas të dhënave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), nga këto dy shtete perëndimore janë nisur më së shumti fluturime për në Kosovë gjatë vitit 2025.

Cilat kompani mund të përfitojnë?

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës mbërrijnë dhe nga ai aktualisht nisen aeroplanët e një numri kompanish ajrore, përfshirë GP Aviation, EasyJet, Eurowings, Edelweiss, Chair Airlines, Austrian Airlines, Lufthansa, Turkish Airlines dhe Wizz Air.

Deri tani, asnjëra prej kompanive nuk ka konfirmuar publikisht nëse do të aplikojë për subvencione.

Radio Evropa e Lirë (REL) kontaktoi disa prej tyre për të kuptuar nëse janë informuar për programin.

GP Aviation, një nga operatorët që ka zgjeruar rrjetin e destinacioneve nga Prishtina në vitet e fundit, duke përfshirë Gjermaninë dhe Zvicrën, nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it lidhur me këtë skemë.

Në vitin 2025, sipas statistikave të

AAC-së, GP Aviation ishte kompania që pati më shumë trafik të udhëtarëve në Aeroportin e Prishtinës - rreth 1.4 milion. Kompania zvicerane Edelweiss tha se ende nuk është njoftuar nga autoritetet kosovare për programin e subvencioneve. "Ne ende nuk jemi informuar për këtë program, dhe as nuk jemi kontaktuar nga Qeveria. Prandaj, nuk mund t'iu përgjigjem pyetjeve tuaja", thuhet në përgjigjen e kompanisë për REL-in.

Ndërkaq, Chair Airlines, po ashtu kompani zvicerane, refuzoi të komentojë. "Ju lutemi të na mirëkuptoni që Chair Airlines nuk do të komentojë për këtë çështje", tha kompania në një përgjigje me shkrim për REL-in. Kompanitë ajrore nuk u përgjigjën as në pyetjet nëse do t'i anulonin fluturimet këtë verë, dhe si do të mund të ndikonte kjo masë kundër këtij rreziku.

Numri i pasagjerëve nga fluturimet në Aeroportin e Prishtinës ka shkuar duke u shtuar çdo vit, me përjashtim të vitit 2020, kur shpërtheu pandemia e COVID-19.

As Aeroporti i Prishtinës nuk u përgjigj në pyetjet nëse ka pasur indikacion se pritet të ketë ulje të numrit të fluturimeve apo anulime të theksuara këtë vit.

Praktikë e njohur në Evropë

Subvencionimi i linjave ajrore nuk është i pazakontë në Evropë. Viteve të fundit, shtete si Italia, Sllovenia, Suedia dhe Norvegjia kanë përdorur skema të ngjashme për të ruajtur linjat ajrore, për të nxitur turizmin, ose për të mbështetur rajone që varen nga transporti ajror.

Në vitin 2024, Italia miratoi një

skemë prej 30 milionë eurosh për hapjen e linjave të reja drejt Sardenjës, ndërsa një program tjetër prej 120 milionë eurosh u përdor për të nxitur lidhjet ajrore me rajonin e Kalabrisë.

Në Ballkan, Maqedonia e Veriut për disa vite ka përdorur skemat e subvencionimit të kompanive ajrore për të shtuar fluturimet dhe nxitur turizmin.

Megjithatë, jo të gjithë pajtohen se subvencionet për aviacionin janë zgjidhja më e mirë.

Debatit për subvencionet në aviacion po zhvillohet edhe në nivel të Bashkimit Evropian (BE). Në maj të vitit 2026, Komisioni Evropian propozoi rishikimin e rregullave për ndihmën shtetërore në sektorin ajror, duke kufizuar mbështetjen për aeroportet, dhe duke propozuar heqjen graduale të ndihmës për hapjen e linjave të reja, me arsyetimin se "rreziku financiar duhet të bartet nga vetë kompanitë ajrore".

Organizata evropiane Transport & Environment (T&E), e cila merret me politikën e transportit dhe klimës, argumenton se subvencionet për aeroportet dhe linjat ajrore "shpesh nuk përbëjnë përdorimin më efikas të parasë publike për zhvillim rajonal".

Në një dokument të dorëzuar gjatë rishikimit të rregullave të BE-së për ndihmën shtetërore në aviacion - të cilin T&E e ka ndarë me REL-in - organizata vlerësoi se çdo rishikim që lejon që një ndihmë e tillë të vazhdojë duhet të sigurojë përputhje të plotë me objektivin e BE-së për "neutralitetin klimatik dhe Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane". "Për shembull, kushtëzime të rrepta të gjelbra duhet t'i bashkëngjiten çdo ndihme [subvencion] të dhënë", thuhet në dokumentin e T&E.

Bizneset në Shqipëri presin një verë të mirë, shërbimet dhe turizmi rrisin besimin në ekonomi

TIRANË, 5 QERSHOR - Me afrimin e sezonit veror bizneset shqiptare po shfaqen më optimiste për ecurinë e aktivitetit të tyre.

Të dhënat më të fundit të Bankës së Shqipërisë tregojnë se besimi në ekonomi është rritur gjatë muajit me 1.1% maj i udhëhequr kryesisht nga sektori i shërbimeve.

Turizmi, hoteleria, restorantet, transporti dhe aktivitetet e lidhura me sezonin veror po japin sinjalet më pozitive. Bizneset e shërbimeve raportojnë rritje të kërkesës dhe një ecuri më të mirë të aktivitetit, duke reflektuar pritjet për një verë të ngarkuar

me turistë dhe konsum më të lartë. Vet shërbimet raportojnë për një rritje të besimit me 3.4%.

Në të njëjtën linjë vijon dhe sektori i ndërtimit i cili vijon optimizmin edhe pas muajit maj si rezultat i aktivitetit aktual dhe kontratave porositëse.

Në kahun e kundërt, tregtia dhe industria ka shfaqur një ngadalësim të lehtë. Bizneset e këtij sektori janë treguar më pak optimiste për shitjet dhe punësimin në muajt në vijim.

Në këtë situatë të ekonomisë shqiptare konsumatorët shfaqen ende pesimistë. Besimi i konsumatorëve poshtë

mesatares historike tregon gjithashtu hezitim për shpenzime, ndërsa bizneset raportojnë kërkesë më të dobët. Edhe konsumatorët kanë shfaqur më shumë besim krahasuar me një muaj më parë, duke përmirësuar pritshmëritë për financat familjare dhe ekonominë në tërësi.

Të dhënat e vrojtimit të besimit në ekonomi tregojnë se ekonomia shqiptare vijon të mbështetet te dinamika e shërbimeve, por përmirësimi i besimit në disa sektorë njëkohësisht jep sinjale për një aktivitet ekonomik më të gjerë në prag të verës.



ODA EKONOMIKE AMERIKANE: GAZI NATYROR AMERIKAN DUHET TË BËHET PRIORITET STRATEGJIK PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që qasjen në gazin e lëngshëm natyror nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (LNG) dhe zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme të gazit ta trajtojë si prioritet strategjik kombëtar.

Sipas kësaj ode, përveç përfitimeve ekonomike dhe energjetike, një orientim i tillë do të forconte edhe më tej bashkërendimin strategjik të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si partnerin e saj më të rëndësishëm strategjik. "Sistemi energjetik i Kosovës vazhdon të mbështetet në masë të madhe në termocentralet e vjetruara me linjit, ndërsa importi i energjisë elektrike vazhdon të jetë barrë e konsiderueshme për ekonominë. Remontet e planifikuara të kapaciteteve ekzistuese gjeneruese, rritja e kërkesës për energji dhe ekspozimi gjithnjë e më i madh ndaj luhatjeve të tregut e theksojnë edhe më shumë nevojën për një miks energjetik më të diversifikuar dhe më rezistent", thuhet në reagimin e Odës Amerikane, e cila rikujton se projekte të rëndësishme të



infrastrukturës së LNG-së dhe të ndërlidhjes energjetike po zhvillohen në mbarë Evropën Juglindore, duke krijuar mundësi të reja për shtetet që të sigurojnë qasje në burime të diversifikuara të gazit dhe të forcojnë sigurinë e tyre energjetike. "Ndërsa vendet fqinje po pozicionohen brenda këtyre korridoreve të reja energjetike, Kosova rrezikon të

mbetet jashtë një arkitekture rajonale që po bëhet gjithnjë e më përcaktuese për konkurrueshmërinë ekonomike dhe sigurinë afatgjate të furnizimit. Sfidat me të cilën përballon Kosova nuk është më disponueshmëria e furnizimit, por gatishmëria e vendit për ta shfrytëzuar atë. Kjo kërkon investime strategjike në

infrastrukturë, modernizimin e kornizës ligjore dhe rregulatore për gazin natyror, si dhe angazhim më të fuqishëm me partnerët strategjikë. Investimi në infrastrukturën që mundëson qasjen në LNG nga SHBA-ja do të kontribuonte edhe në forcimin e bashkërendimit strategjik të Kosovës, në një kohë kur siguria energjetike dhe siguria

gjeopolitike janë gjithnjë e më të ndërlidhura", është thënë në reagimin e kësaj ode.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka theksuar se përtej forcimit të sigurisë energjetike, qasja në gaz do të ndihmonte në uljen e varësisë nga importet e kushtueshme të energjisë elektrike, do të ofronte fleksibilitet më të madh për integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe do të rriste konkurrueshmërinë e industrive të Kosovës në një kohë kur kërkesat rregullative të Bashkimit Evropian, që lidhen me emetimet e karbonit po bëhen më rigorozë dhe si të tilla do të afektojnë eksportuesit.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka bërë thirrje Qeverisë që të demonstrojë vullnetin politik duke ndërmarrë hapa konkretë drejt integritetit të Kosovës në rrjetet rajonale të gazit. "Mungesa e veprimit rrezikon të zgjasë cenueshmërinë energjetike të vendit dhe të kufizojë potencialin e tij ekonomik, ndërsa veprimi në kohë mund të ndihmojë në sigurimin e një të ardhmeje energjetike më të qëndrueshme, më konkurruese dhe më të sigurt", thuhet në këtë reagim.

GAP-i: Të hyrat e komunave nga tatimi në pronë u rritën 19% në 2025

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Instituti GAP ka publikuar të dhëna lidhur me të hyrat e komunave nga tatimi në pronë, duke bërë me dije se këto të hyra kanë shënuar rritje të ndjeshme në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak.

Sipas GAP-it, të hyrat totale të komunave nga tatimi në pronë janë rritur për 19 për qind në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024, duke arritur në 39.1 milionë euro. "Të hyrat totale të komunave nga tatimi

në pronë janë rritur për 19% në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, duke arritur në 39.1 milionë euro", thuhet në postimin e publikuar nga Instituti GAP.

Në njoftim thuhet se krahasuar me vitin 2024, komunat me rritjen më të madhe përqindore të të hyrave nga tatimi në pronë gjatë vitit 2025 kanë qenë Podujeva, Suhareka, Viti, Istogu dhe Gjilani.

Ndërkohë, sipas të dhënave të

publikuara, rëniet më të theksuara në këtë kategori të të hyrave janë shënuar në komunat Deçan, Kaçanik, Mamusha dhe Partesh.

Po ashtu, Instituti GAP ka theksuar se në periudhën 2022-2025, megjithëse në disa komuna janë vërejtur luhatje në inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë, disa komuna të tjera kanë arritur që gradualisht t'i dyfishojnë të hyrat nga kjo kategori brenda kësaj periudhe.



IZRAELI FUTI USHTRINË DHE MOSADIN NË AZERBAJXHAN - CNN: IRANI U RRETHUA, MISIONI SEKRET QË NDRYSHOI LUFTËN

Detaje të reja tronditëse kanë dalë në dritë për luftën Izrael- Iran. Sipas një raporti ekskluziv të CNN, Forcat e Armatosura të Tel Avivit kishin ngritur një rrjet të fshehtë bazash ushtarake dhe pozicione të inteligjence në disa vende të Lindjes së Mesme, duke rrethuar praktikisht Iranin nga veriu, perëndimi dhe jugu.

Një nga operacionet më të ndjeshme, i mbajtur larg syve të publikut deri më tani, ishte vendosja e forcave elitare izraelite në Azerbajxhan, fare pranë kufirit verior të Iranit. Burime të njohura me operacionin kanë zbuluar se komandot speciale, personel i Mossad-it dhe njësi të forcave speciale izraelite u stacionuan në disa pika në jug të Azerbajxhanit, vetëm rreth 100 kilometra larg qytetit iranian të Tabrizit, i cili u godit gjatë konfliktit.

Sipas raportit, këto njësi nuk kishin vetëm rol mbështetës. Ato kryen misione të fshehta zbulimi, operacione me dronë dhe grumbulluan informacione



të vlefshme për lëvizjet e ushtrisë iraniane. Pozicioni strategjik pranë kufirit i lejoi Izraelit të monitoronte nga afër aktivitetet ushtarake në veri të Iranit dhe të siguronte paralajmërime të hershme për lëshimet e mundshme të raketave.

Ky ishte vetëm një fragment i një strategjie shumë më të gjerë. Burimet flasin për praninë e forcave izraelite edhe në Irak, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Somaliland, duke krijuar një rrjet të avancuar operacional që i dha Izraelit një shtrirje të

paprecedentë gjatë luftës. Fillimisht të menduara si pika emergjente për shpëtimin e pilotëve ose operacione kërkim-shpëtimi, këto pozicione u shndërruan në baza të mirëfillta inteligjence dhe mbështetjeje ushtarake.

Ndërkohë, në Irak, Izraeli mbajti dy objekte sekrete operative për mbështetje logjistike dhe operacione të mundshme shpëtimi. Në Emiratet e Bashkuara Arabe, Tel Aviv vendosi fshehurazi një bateri të sistemit mbrojtës "Iron Dome", së bashku me personelin e nevojshëm për funksionimin e saj.

Sipas burimeve të CNN, përgatitjet për operacionin në Azerbajxhan kishin nisur muaj përpara shpërthimit të luftës. Në janar, agjentë dhe forca speciale izraelite vendosën pajisje përgjimi dhe sisteme inteligjence pranë kufirit me Iranin. Fillimisht, operacioni ishte planifikuar të zhvillohej paralelisht me një seri goditjesh amerikane kundër Iranit. Por presidenti amerikan Donald Trump tërhoqi në momentin e fundit planin e sulmeve, pasi Teherani kishte premtuar ndalimin e represionit ndaj protestuesve.

ZELENSKY I SHKRUAN LETËR PUTINIT: MË DIL PËRBALLË DHE MBYLLIM LUFTËN



Zelensky i shkruan Putinit një letër të hapur për të mbyllur luftën. Presidenti i Ukrainës propozoi që të dy udhëheqësit të takohen ballë për ballë për t'i dhënë fund më shumë se katër viteve konflikt, duke paralajmëruar se Kievi ishte gati të luftonte përndryshe.

"Ukraina propozon përfundimin e kësaj lufte përmes një angazhimi të drejtpërdrejtë midis nesh dhe jush. Unë propozoj një takim. Të gjithë i dëgjuan përfaqësuesit tuaj, duke buzëqeshur, të thoshin se një goja mund të vijë në Moskë.

Por pas këtyre 26 viteve, nuk ka asgjë për një udhëheqës ukrainas për të bërë në kryeqytetin tuaj, ashtu siç nuk ka asgjë për një udhëheqës rus për të bërë në Kiev. Ka vende që tradicionalisht kanë pritur udhëheqës për të zgjidhur çështje lufte dhe paqeje. Zvicra, Turqia, vendet e botës arabe, shumë prej tyre janë në gjendje dhe të gatshme të presin një takim të tillë. Janë udhëheqësit ata që zgjidhin çështjet kryesore. Kështu ka qenë gjithmonë dhe kështu do të jetë gjithmonë. Unë propozoj të caktohet një datë e qartë për një


takim të tillë", lexohet në letrën e Zelenskyt.

Presidenti rus Vladimir Putin konfirmoi se Rusia është plotësisht e përgatitur dhe e gatshme të negociojë me Ukrainën në një bazë ushtarake amerikane në Anchorage të Alaskës, ndërsa homologu i tij ukrainas propozoi një takim ballë për ballë: "Nëse z. Zelenskiy është një përfaqësues legjitim i Ukrainës, kjo është një pyetje për juristët, për një analizë ligjore. Sigurisht që do të dëshironim, nëse do të vinte ndonjëherë, nënshkrimin e ndonjë dokumenti, dhe mendoj

se kjo nuk është një tekë e jona. Sigurisht, çdo vend në pozicionin tonë duhet të nënshkruajë dokumente të tilla, të cilat pa ekzagjerim janë historike si nga perspektiva e Rosisë ashtu edhe e Ukrainës, me personat që janë legjitimë sipas Kushtetutës së një vendi partner. Në këtë rast është Ukraina".

Në letrën e tij, të cilën zyra e Presidentit tha se i ishte dërguar vendeve të tjera, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Zelenski nënvizon se shumica e rusëve ishin lodhur nga sulmet me raketa dhe dronë të Ukrainës,

inflacioni dhe mungesa e karburantit, dhe ishin gati për paqe. Ai nënvizon më tej se me Shtetet e Bashkuara të përqendruara në konfliktin në Iran, "do të ishte gabim të prisnim thjesht derisa lufta në Evropë të rikthehej në qendër të vëmendjes së tyre". Rruga drejt paqes, thekson Zelenski, duhet të fillonte në vijën e frontit, "vija nga e cila duhet të fillojë diplomacia". Ukraina, tha Zelenski, mbështet "një armëpushim të plotë për kohëzgjatjen e negociatave. Kjo është praktikë standard".



EURO GLASS
SAINT-DISAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

'Dardanet' gati për sfidat evropiane në volejboll

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Kombëtarja A e femrave e Kosovës në volejboll është gati për debutimin në edicionin 2026 të CEV Volleyball European League, pas një

periudhe intensive përgatitore dhe një serie stërvitjesh e ndeshjesh kontrolluese. Nën drejtimin e përzgjedhësit Darko Prebiraçević dhe stafit të tij teknik, ekipi ynë

kombëtar do të nisë rrugëtimin evropian këtë fundjavë në Letoni, ku do të zhvillohen dy ndeshjet e para të garës. Kosova do të përballet sot (e shtunë) me

Rumaninë, ndërsa nesër (e diel) do ta sfidojë nikoqirin Letoninë, në kërkim të një starti pozitiv në këtë kompeticion të rëndësishëm evropian.



EMINI NË STAMBOLL: SPORTI ËSHTË MJET I FUQISHËM PËR GJITHËPËRFSHIRJE DHE NDRYSHIM SHOQËROR

STAMBOLL, 5 QERSHOR - Presidentja e Komitetit Paralimpik të Kosovës, Njomza Emini, ka njoftuar se ka prezantuar Kosovën në sesionin "Small Country, Big Impact: Developing Inclusive Para Sport Initiatives", në Stamboll. Emini ka shkruar në "Facebook" se për një vend të vogël si Kosova, çdo hap përpara kërkon shumë përkushtim, partneritete

të forta dhe besim se sporti mund të jetë një mjet i fuqishëm për gjithëpërfshirje dhe ndryshim shoqëror. "Në kuadër të European Para Youth Games Legacy Initiative në Stamboll, pata kënaqësinë të prezantoj përvojën e Kosovës në sesionin "Small Country, Big Impact: Developing Inclusive Para Sport Initiatives" para përfaqësuesve të organizatave dhe komiteteve

të ndryshme evropiane, ku u diskutua mbi politikat, qeverisjen, financimin dhe zhvillimin e parasportit. Për një vend të vogël si Kosova, çdo hap përpara kërkon shumë përkushtim, partneritete të forta dhe besim se sporti mund të jetë një mjet i fuqishëm për gjithëpërfshirje dhe ndryshim shoqëror. Pavarësisht sfidave të shumta që na shoqërojnë në



çdo hap, ne vazhdojmë të dëshmojmë se asnjë pengesë nuk është më e madhe se vullneti për të ecur përpara dhe

për të ndërtuar një lëvizje paralimpike të denjë për sportistët dhe vendin tonë. Faleminderit European Paralympic Committee për mundësinë për të prezantuar rrugëtimin e Komitetit Paralimpik të Kosovës, i cili me përkushtim dhe këmbëngulje po vazhdon të zhvillojë lëvizjen paralimpike në Kosovë", ka shkruar Emini.

PËRFUNDON ME SUKSES PUNËTORIA TREDITORE "FIFA TALENT DEVELOPMENT SCHEME"

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Në Kampin Nacional të Federatës së Futbollit të Kosovës në Hajvali ka përfunduar me sukses punëtorja treditore në kuadër të projektit "FIFA Talent Development Scheme (TDS)", e organizuar në bashkëpunim me ekspertë të FIFA-s. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë trajnerët e programit "FFK Talent Coach Academy", përfaqësues të projektit "Elite Youth Development", edukatorët e trajnimeve të FFK-së, si dhe persona të angazhuar në zhvillimin e futbollit të të rinjve në klube dhe në ekipet kombëtare.



Gjatë tri ditëve të punës, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të diskutojnë dhe të shkëmbejnë përvoja me ekspertë ndërkombëtarë rreth temave të rëndësishme si identifikimi i talenteve, zhvillimi i tyre,

skautimi, efekti i moshës relative, maturimi fizik dhe ndikimi i këtyre faktorëve në rritjen e futbollistëve të rinj. Eksperti i FIFA-s, Arnar Vidarsson, ka vlerësuar rëndësinë e kësaj punëtorie dhe bashkëpunimit në mes të profesionistëve vendorë dhe ndërkombëtarë. "Jemi me fat që kemi ligjërues nga Evropa, përfshirë ekspertë që punojnë në akademi të mëdha në Holandë, siç është Feyenoord. Gjithashtu kemi edhe kolegun tim nga FIFA, Andrew Gould, i cili deri para pak muajsh ishte drejtor teknik i Federatës Skoceze të Futbollit", ka

thënë Vidarsson. Ndërsa eksperti tjetër i FIFA-s, Andrew Gould, ka theksuar se qëllimi kryesor i këtij projekti është mbështetja e Kosovës në zhvillimin e talenteve cilësore për të ardhmen. Në anën tjetër, shefja e Departamentit të Edukimit në FFK, Sanije Krasniqi, ka theksuar se FFK-ja i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të talenteve dhe krijimit të strukturave të qëndrueshme për identifikimin dhe avancimin e tyre. "Ky është

hapi i parë i këtij lloj trajnimit, pasi shumë shpejt do të vazhdojmë edhe me trajnimin për analizën e lojtarëve, i cili do të realizohet bashkërisht me FIFA-n", ka theksuar Krasniqi. Përmes projektit "FIFA Talent Development Scheme", FFK-ja synon të avancojë edhe më tej sistemin e punës me talentët e rinj, duke forcuar kapacitetet profesionale të trajnerëve, edukatorëve dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin e futbollit të të rinjve në Kosovë.


FC PRISHTINA E NIS 'REVOLUCIONIN' E PARALAJMËRUAR, E PREZANTON MALSOR GJONBALAJN

PRISHTINË, 5 QERSHOR - FC Prishtina ka njoftuar zyrtarisht arritjen e marrëveshjes me Malsor Gjonbalajn, i cili do t'i bashkohet klubit në rolin e udhëheqësit të këshillit profesional. Klubi bardhekaltër e ka cilësuar këtë emërim si një hap të rëndësishëm në vazhden e përpjekjeve për të forcuar strukturat profesionale

dhe për të ndërtuar një vizion afatgjatë zhvillimor. Përveç angazhimit të tij në fushën akademike, Gjonbalaj ka dhënë ndër vite një kontribut të çmuar në futbollin e Kosovës. Kualifikimet dhe përvoja e tij në aspektin akademik, shkencor dhe profesional e bëjnë atë një nga figurat më të respektuara në vend,

ndërsa angazhimi i tij shihet si dëshmi e ambicieve të FC Prishtinës për të afruar personalitetet më eminente në strukturat e klubit. "Me përvojën dhe ekspertizën e tij, ai do të luaj një rol të rëndësishëm në hartimin e planeve të përgjithshme zhvillimore të klubit, me fokus të veçantë në avancimin e

Akademisë së të Rinjve. Jemi të bindur se angazhimi dhe vizioni i tij do të kontribuojnë në forcimin e mëtejshëm të FC Prishtina dhe në realizimin e objektivave tona afatgjata duke synuar suksese më të mëdha. Mirë se u ktheve në familjen bardhekaltër, prof. Gjonbalaj!", ka njoftuar FC Prishtina.



Liverpooli zyrtarizon trajnerin Iraola

Liverpool, 5 qershor - Liverpooli e ka emëruar Andoni Iraolan si trajner të ri të skuadrës, pas shkarkimit të Arne Slotit. "The Reds" ka njoftuar për largimin e Slotit të shtunën, një vit pasi holandezi e kishte udhëhequr skuadrën drejt titullit të Premier Leagues. Ish-trajneri i

Bournemouthit, 43-vjeçari Iraola, i bashkohet Liverpoolit pas suksesit që kishte me skuadrën që ka përfundur në pozitën e gjashtë. Ishte vetëm një pozitë dhe tri pikë prapa Liverpoolit që ka siguruar Ligën e Kampionëve. Bournemouthi në sezonin

tjetër do të luajë në Ligën e Evropës. Spanjoli Iraola në muajin prill kishte njoftuar se do të largohej nga Bournemouthi në këtë verë dhe ishte i lidhur për ta marrë drejtimin e Crystal Palacet apo Milanit. Por, ka vendosur të transferohet

në "Merseyside", me Liverpoolin që ka siguruar Ligën e Kampionëve me 60 pikë, që janë shifrat më të ulëta që nga kampanja 2015/16. Iraola si pjesë e stafit do t'i marrë me vete ata që i kishte te Bournemouthi, Tommy Elphickun dhe Shaun Cooperin.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Fashion Center” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811410521 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Fashion Center” D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811410521 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Fashion Center” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 811410521 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Garden Caffè Bar&More” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811390864 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Garden Caffè Bar&More” D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811390864 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Garden Caffè Bar&More” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 811390864 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gjella House” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811445726 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gjella House” D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811445726 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Gjella House” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 811445726 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Restaurant BOTA” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811398412 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Restaurant BOTA” D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811398412 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Restaurant BOTA” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 811398412 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “GLAM New York Dresses” SH.P.K. pronar Besnik Asllani me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810148975 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “GLAM New York Dresses” D.O.O. Besnik Asllani Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810148975 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “GLAM New York Dresses” L.L.C. with owner Besnik Asllani with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810148975 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Prishtinë, 03.06.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 81050100 me adresë: Rr. „Adem Jashari“, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.05.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **0.57 MW** ZK Prekallë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **0.57 MW** ZK Prekallë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.6336-2/25 dt. 03.12.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore nr. 11-351-40062/145 dt. 21.11.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimi për Leje Ndërtimore Nr. 11-351-45958/158 dt. 30.12.2025 për “Instalimin e Sistemit Solar Fotovoltaik- me kapacitet 0.57 MW, ngastrata katastrale 00371-6, dhe 00371-7 ZK Prekallë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 5723 dt. 22.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: elektrosystem16@gmail.com dhe LEGAL-LENCENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Global Plastics” SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 812300846.

- Erina Cubi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI të Gjimnazit “Eqrem Çabej” Prishtinë.

- “Zoom Mobile” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811962837.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK “11 Marsi” Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. “Ibrahim Fehmiu” Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK “11 Marsi” Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- “Restorant te Besi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

